



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatori ekonomik "Glavenica" shpk
Adresa:Rr. Ndre Mjeda" Tiranë.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: "Procedure e Hapur" "Shtimi i sipërfaqeve të Varrezave Publike Tufinë".

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Shtimi i sipërfaqeve të Varrezave Publike Tufinë".

Numri i references se procedures/lotit: REF-50782-02-18-2020

Fondi limit: 49,999,897.92 (dyzetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2020, miratuar me VKB Nr. 157, datë 26.12.2019 "Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2020 – 2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020".

Kohëzgjatja e kontratës: 9 (nëntë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 21.05.2020, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 7 datë 24.02.2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik "Glavenica" shpk

NUIS K17710805A

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 32,116,386 (tridhjetë e dy milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

1. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik "Ndërtimi" shpk & "Colombo" shpk
NUIS K11325002C **NUIS J82916489E**

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 36,262,076 (tridhjetë e gjashtë milion e dyqind e gjashtedhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk

NUIS K51501008J

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 37,777,777 (tridhjetë e shtatë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

3. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Spektri” shpk & “Jogi” shpk. NUIS J62903555F NUIS J63229478K

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 38,711,820.98 (tridhjetë e tetë milion e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzetë pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë

4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk.

NUIS K57923807W

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 41,059,177.30 (dyzetë e një milion e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë tridhjetë) lekë.

5. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Pepa Group” shpk

NUIS L42215009L

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 41,970,324.56 (dyzetë e një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e njëzetë e katër pikë pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

6. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “BE-IS” shpk NUIS K71412003A

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 41,976,233 (dyzetë e një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë.

7. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Leon Konstruksion” shpk

NUIS K71820009I

Çmimi total i ofertës pa TVSH = 42,498,880.20 (dyzetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë pikë njëzetë) lekë.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

- **Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Spektri” shpk & “Jogi” shpk.**

- **Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk**

Mungesa e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik si dhe mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

1. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Spektri” shpk & “Jogi” shpk.

- Shoqëria “Jogi” shpk nuk disponon Çertifikatën ISO 50001-2012, ndërkohë referuar Akt marrëveshjes në të cilën janë përcaktuar ndarjet e zërave të Preventivit, rezulton se kjo shoqëri ka marrë përsipër punime ndriçimi rruge. Për sa më lart, Shoqëria “Jogi” shpk nuk plotëson DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 11, gërma “f”.
- Referuar dokumentacionit të paraqitur për Mjekun e shoqërisë, rezulton se Licenca për ushtrimin individual të profesionit nuk është e vlefshme, pasi i ka përfunduar afati më 15.02.2020, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka paraqitur dokumentacion për 2 (dy) punonjës murator. Pas verifikimeve, u konstatua se për njërin murator nuk është paraqitur Diploma/Dëshmia lëshuar nga institucione të akredituara, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8.
- Referuar Shtojcës 13, Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobitumatriçe me targa AFR 628. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur mbi disponimin e mjetit të sipërcituar, u konstatua se nuk është paraqitur Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, gërma “c”.
- Referuar Shtojcës 13, Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon nëpërmjet kontratës së qirasë 1 (një) Autobetoniere me targa FR 3854 D. Pas verifikimeve u konstatua se mjete i sipërcituar nuk mund të jepet me qera pasi disponon *Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet*, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12, gërma “b”.
- Referuar Shtojcës 13, Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobot Uji me targa AA 203 EZ. Pas verifikimeve u konstatua se mjete i sipërcituar rezulton se është Autobot naftë dhe jo uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12.

2. Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk.

- Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk nuk plotëson pikën 2 të kapacitetit

ekonomik dhe financiar të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2017, 2018, 2019) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 50% e vlerës së fondit limit perkatesisht:*

- Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk nuk plotëson pikën 2 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën....”* pasi për kontratën e ngjashme të praqitur si bashkim operatorësh ekonomikë nuk është praqitur kontrata e bashkëpunimit dhe prokura e posacme.
- Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk nuk plotëson pikën 2 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Një punësim mesatar i të paktën 45 (dyzetë e pesë) personave, për periudhën Shkurt 2019 - Shkurt 2020 të vërtetuar me.....”* pasi për Ska praqitur urdher pagesat nga muaji prill 2019 e ne vazhdim.
- Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk nuk plotëson pikën 6 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçense per ushtrimin individual te profesionit, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.(Në mbështetje të VKM Nr. 692 datë 13.12.2001 ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, Neni 12/1 Operatorët ekonomik pjesmarrës që kanë të punësuar më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nuk kanë detyrim ligjor plotësimin e kërkesës së mësipërme.)”* pasi Mjekut i mungon licensa e ushtrimit te aktivitetit.
- Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk nuk plotëson pikën 9 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës Eskavatorist, 2 (dy) Buldozerist, 4 (katër) Automakinist, për të cilët duhet të praqitet kontrata e punës e vlefshme, Deshmi e Aftesise Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit”* pasi janë deklaruar 3 buldozerist por ne deshmi rezultojne eskavatorist.
- Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk nuk plotëson pikën 9 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës Eskavatorist, 2 (dy) Buldozerist, 4 (katër) Automakinist, për të cilët duhet të praqitet kontrata e punës e vlefshme, Deshmi e Aftesise Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit”* pasi janë deklaruar 2 automakinist por ne deshmi rezultojne eskavatorist.
- Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” shpk nuk plotëson pikën 8 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet pergjegjese shtetore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të*

akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, si më poshtë.....” pasi hidrauliket e deklaruar skane dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, Njeri nga 2 elektriket e deklaruar s’ka dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, Karpentieret e deklaruar dhe Bojaxhiu I deklaruar skane dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik. gjithashtu Jane paraqitur 3 murator te cilet skane dokumentacion te rregullt dhe Eshte deklaruar 1 teknik ndertimi per te cilin nuk eshte paraqitur deshmi apo diploma perkatese.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Glavenica” shpk me adresë “Lagjia 5 Shkurti, Ballsh ; Rr. Ndre Mjeda” Tiranë,** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme 32,116,386 (tridhjetë e dy milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH është identifikuar si **oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 36,262,076 (tridhjetë e gjashtë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 10.06.2020

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.